



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.365/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesës A.nr.365/2022 të datës 14.04.2022 të parashtruar nga ankuesi Lulzim Rifaj, e bashkuar sipas Vendimit me Nr.21/2022 të datës 05.05.2022, dhe të përfaqësuar nga avokati Hajzer Salihu dhe avokati Faton Fetahu, nga Prishtina, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 10.06.2022, më shumicë votash mori këtë:

### V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.365/2022 të datës 14.04.2022 e parashtruar nga ankuesit Lulzim Rifaj, Frymëzim Isufaj, Mitat Fejza, Bahrije Hoti, Rrahim Morina, Binak Berisha, Shota Bukoshi, Adnan Dragaj, Enver Buçaj dhe Blerim Canaj.

### A r s y e t i m

Ankuesi Frymëzim Isufaj me datë 09.03.2022 përmes përfaqësuesit me autorizim avokatit Faton Fetahu ka parashtruar ankesë me numër regjistrimi A.nr.214/2022 kundër Vendimit me numër protokoll 341 të datës 08.02.2022 të Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje MPJD), ndërsa përmes përfaqësuesit me autorizim Avokat Hajzer Salihu me datë 14.04.2022 parashtronjë ankesë Mitat Fejza ankesën me numër të regjistrimit A.nr.364/2022 kundër Vendimit me numër protokoll 875 të datës 16.03.2022 të Ministres së MPJD-së, ankuesi Lulzim Rifaj ankesën më numër të regjistrimit A.nr.365/2022 kundër Vendimit me numër protokoll 873 të datës 16.03.2022 të Ministres së MPJD-së, ankuesja Bahrije Hoti ankesën më numër të regjistrimit A.nr.366/2022 kundër Vendimit më numër protokoll 879 të datës 16.03.2022 të Ministres së MPJD-së, ankuesi Rrahim Morina ankesën më numër A.nr.367/2022 kundër Vendimit me numër protokoll 876 të datës 16.03.2022 të Ministres së MPJD-së, ankuesja Shota Bukoshi ankesën me numër regjistrimi A.nr.369/2022 kundër Vendimit me numër protokoll 874 të datës 16.03.2022 të Ministres së



MPJD-së, ankuesi Adnan Dragaj ankesën me numër regjistrimi A.nr.370/2022 kundër Vendimit me numër protokolli 871 të datës 16.03.2022 të Ministres së MPJD-së, ankuesi Binak Berisha ankesën me numër të regjistrimit A.nr.368/2022 kundër Vendimit me numër protokolli 880 të datës 16.03.2022 të Ministres së MPJD-së, ankuesi Enver Buçaj ankesën me numër të regjistrimit A.nr.371/2022 kundër Vendimit me numër protokolli 878 të datës 16.03.2022 të Ministres së MPJD-së, dhe ankuesi Blerim Canaj ankesën me numër të regjistrimit A.nr.372/2022 kundër Vendimit me numër protokolli 877 të datës 16.03.2022 të Ministres së MPJD-së.

Duke pas parasysh së ankesat bazohen në të njëjtën gjendje faktike dhe bazë të njëjtë ligjore, me Vendimin Nr.21/2022 të datës 05.05.2022 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është bërë bashkimi i ankesave në një ankesë me numër A.nr.365/2022.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën A.nr.214/2022 të datës 08.03.2022 me numër protokolli 1225/2022 e parashtruar nga ankuesi Frymëzim Isufaj në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës se bashku me shkresat e bashkangjitura: Autorizimin e datës 04.03.2022; Vendimin me Nr. Ref: 127/13 i datës 20.03.2013 për emërim dhe caktim të gradës diplomatike për ankuesin; Vendimin me Nr.Ref:030/2016 i datës 29.01.2016 për ngritje në gradë për ankuesin; Dekretin me Nr. 156/2020 i datës 29.10.2020 i Presidentit të Republikës së Kosovës; Vendimin me Nr.Ref:168/14 i datës 19.03.2014 për lëvizje paralele dhe transfer për ankuesin; Vendimin me Nr.581/2018 i datës 13.07.2018; Vendimin me Nr.135/2020; Kërkesën për punësim të ankuesit e datës 19.08.2011; Certifikatën për gjendjen shëndetësore e datës 16.08.2011; Vërtetimin me Nr.0353/11 i datës 18.08.2011; Formulari i të dhënave për listën e pagave i datës 11.06.2013; Emailin për pjesëmarrje në testim i datës 28.01.2011 për ankuesin nga Zyra e Personelit MPJ; Deklaratën e datës 04.03.2022; Deklaratën nën Betim e datës 18.06.2015; Kërkesë për gradim e datës 08.09.2015 nga ankuesi; Vendim me Nr. Ref: 112/2022 i datës 04.03.2022; Vendimin me Nr. 68/2022 i datës 08.02.2022; Shkresën me titull opinion lidhur me propozimin e MPJ-së për miratimin e gradës diplomatike Ambasador për ankuesin e datës 28.10.2020; Vendimin me Nr.Ref:700/2020 i datës 22.09.2020; Propozim DP/115/21 shtator 2020; Parashtrësën nga ankuesi e datës 07.04.2022; Konkurs për anëtar të Personelit Diplomatik i datës 22.07.2011; Shkresë me titull raporti final i auditimit menaxhimi i burimeve njerëzore i datës 03.11.2021; Shkresë me Nr. ref:107 i datës 02.03.2022; Vendimin me Nr.Ref:135/2022 i datës 14.03.2022; Ftesë për testim për gjuhë kroate/serbe dhe boshnjake; Ftesë për gjuhën gjermane; Testimi për gjuhë angleze; Njoftim për intervistë e datës 02.06.2012 nga Zyra e Personelit MPJ; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 15.03.2022; Përgjigje në ankesë 24.03.2022; Dekretin me Nr. i dekretit: 90/2012 i datës 18.03.2022; Kartelën e nëpunësit viti 2011, 2012, 2013; Provë shtesë nga MPJD e datës 28.04.2022; Provë shtesë nga MPJD e datës 17.05.2022; Dekretin për Themelimin e Misionit Diplomatik i datës 18.06.2008; Autorizim për publikim të konkursit i datës 11.03.2019; Vendimin VK.nr.27/2022 i datës 20.04.2022 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën A.nr.364/2022 të datës 14.04.2022 me numër protokolli 2086/2022 e parashtruar nga ankuesi Mitat Fejza në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës se bashku me shkresat e bashkangjitura: Autorizimin e datës 18.03.2022; Konkursi për drejtues dhe nëpunës tjerë të misionit konsullor i datës 22.07.2011; Vendimin me Nr. Ref:149/2022 i datës 15.03.2022; Emailin e datës 16.03.2022 për ankuesin; Kërkesë për qasje në dokumente zyrtare e datës 21.03.2022; Shpallje e Shprehje se Interesit e datës 08.02.2022; Vendimin me Nr.Ref:242/13 i datës 10.05.2013; Vendimin me Nr. 197/2016 i datës 13.05.2016; Vendimin me Nr.572/2018 i datës 13.07.2018; Vendimin me Nr.

35/2018 i datës 18.01.2018; Vendimin me Nr.Ref:111/2020 i datës 27.03.2020; Vendimin me Nr.327/2020 i datës 10.07.2020; Vendimin me Nr.122/2020 i datës 01.09.2020; Akt Emërimit AE.Nr.11/2021 i datës 19.02.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 19.04.2022; Përgjigje në ankesë e datës 26.04.2022; Vendimin për shpallje të konkursit me Nr.140/11 i datës 21.07.2011; Lista e kandidatëve aplikues për misione diplomatike gusht 2011; Vendimin me Nr Ref:284/2016 i datës 08.07.2016; Vendimin me Nr.198/202 i datës 13.05.2020; Vendimin me Nr. 259/2020 i datës 30.06.2020; Emailin e datës 26.04.2022 nga V.Berisha; Provë shtesë nga MPJD e datës 26.04.2022; provë shtesë nga MPJD e datës 11.05.2022; Dekretin e datës 18.06.2008 me Nr. i dekretit DMD-003-2008; Ankesën A.nr.365/2022 të datës 14.04.2022 me numër protokolli 2087/2022 e parashtruar nga ankuesi Lulzim Rifaj në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 18.03.2022 se bashku me shkresat e bashkangjitura: Vendimin me Nr. Ref:1060/12 i datës 13.11.2012; Vendimin me Nr. Ref:797/2018 i datës 10.09.2018; Vërtetim i datës 20.05.2013 për ankuesin; Vendimin me Nr.206/2016 i datës 13.05.2016; Vendimin me Nr.Ref: 273/2016 i datës 27.06.2016; Vendimin me Nr.339/2019 i datës 15.07.2019; Vendimin me Nr. 432/2019 i datës 08.09.2019; Vendimin me Nr.302/2020 i datës 10.07.2020; Akt Emërimit AE.Nr.08/2021 i datës 19.02.2021; Vendimin me Nr.133/2020 i datës 01.09.2020; Vendimin me Nr Ref:152/2022 i datës 15.03.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 19.04.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 26.04.2022; Kërkesën për punësim të ankuesit e datës 08.08.2011; Emailin e datës 16.03.2021 për ankuesin; Emailin e datës 27.01.2021 nga A.Krasniqi; Provë shtesë e datës 11.05.2022; Dekretin e datës 18.06.2008 me Nr. DMD-004-2008; dhe Dekretin me Nr. DMK-001-2009; Ankesën A.nr.366/2022 të datës 14.04.2022 me numër protokolli 2088/2022 e parashtruar nga ankuesja Bahrije Hoti në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës se bashku me shkresat e bashkangjitura: Autorizimin e datës 17.03.2022; Vendimin me Nr.Ref:193/14 i datës 08.04.2014; Vendimin me Nr.87/2017 i datës 02.03.2017; Vendimin me Nr. Ref:773/2018 i datës 10.09.2018; Vendimin me Nr.Ref:445/2020 i datës 27.07.2020; Vendimin me Nr.124/2020 i datës 01.09.2020; Vendimin me Nr.Ref:147/2020 i datës 15.03.2022; Njoftim për intervistë nga Zyra e Personelit MPJ datë 04.06.2012 dhe 02.06.2012 për ankuesen; Njoftimin për testim për gjuhën gjermane i datës 01.02.2012; Informatë me rëndësi e datës 03.02.2021; Njoftim për testim për gjuhë angleze e datës 06.02.2012; Njoftim për testim për gjuhën kroate/serbe dhe boshnjake e datës 31.01.2012; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 29.04.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 11.05.2022; Akt Emërimi AE.Nr.05/2021 i datës 19.02.2021; Përshtkrimi i detyrave të punës Zyrtar i Lartë për imunitete dhe Privilegeje i datës 17.04.2015; Vendimin me Nr.146/2015 i datës 27.10.2015; Vendimin me Nr.048/2015 i datës 30.12.2015; Provë shtesë nga MPJD e datës 11.05.2022; Dekretin me Nr.DMD-008-2008 i datës 18.06.2008; Dekretin me Nr.DMK-002-2009 i datës 10.02.2009; Ankesën A.nr.367/2022 të datës 14.04.2022 me numër protokolli 2089/2022 e parashtruar nga ankuesi Rrahim Morina në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura: Autorizimin e datës 17.03.2022; Vendimin me Nr.Ref: 725/2012 i datës 26.07.2012; Dekretin me Nr.DED-016-2012 i datës 31.07.2012; Vendimin me Nr. Ref:210/2017 i datës 20.07.2017; Vendimin me Nr.846 i datës 16.10.2018; Vendimin me Nr.34/2018 i datës 18.01.2018; Vendimin me Numër:453/2019 i datës 28.10.2019; Vendimin me Nr.470/2019 i datës 12.12.2019; Vendimin me Nr.304/2020 i datës 10.07.2020; Vendimin me Nr.Ref:144/2022 i datës 15.03.2022; Ftesë për pjesëmarrje në testim e datës 28.01.2012 nga Zyra e Personelit MPJ për ankuesin; Njoftimin për intervistë e datës 10.06.2012 nga ankuesin për Zyrën e Personelit MPJ; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 20.04.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 29.04.2022; Akt Emërimit AE.Nr.18/2021; Kërkesën për punësim të ankuesit e datës 22.08.2011; CV-në e ankuesit; Dëshmi për dokumentet e dorëzuara e datës 22.08.2011; Emailin e datës

29.04.2022 nga V.Berisha; Ankesën A.nr.368/2022 të datës 14.04.2022 me numër protokollin 2090/2022 e parashtruar nga ankuesi Binak Berisha në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura: Autorizimin e datës 17.03.2022; Vendimin me Nr.Ref:1061/12 i datës 13.11.2012; Vendimin me Nr.293/2014 i datës 29.04.2014; Vendimin me Nr. ref:040/2015 i datës 01.12.2015; Vendimin me Nr.340/2016 i datës 12.08.2016; Vendimin me Nr. 54/2015 i datës 19.06.2015; Vendimin me Nr.Ref:183/2017 i datës 12.06.2017; Vendimin me Nr.590/2018 i datës 13.07.2018; Vendimin me Nr.Ref:113/2020 i datës 27.03.2020; Vendimin me Nr. 303/2020 i datës 10.07.2020; Vendimin me Nr.136/2020 i datës 01.09.2020; Vendimin me Nr.Ref: 148/2022 i datës 15.03.2022; Ftesë për pjesëmarrje në testim datë 27.01.2012 nga Zyra e Personelit MPJ; Njoftimin për intervistë i datës 02.06.2012; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 19.04.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 26.04.2022; Kërkesën për punësim e ankuesit e datës 12.08.2011; Ankesën A.nr.369/2022 të datës 14.04.2022 me numër protokollin 2091/2022 e parashtruar nga ankuesja Shota Bukoshi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura: Autorizimin e datës 18.03.2022; Vendimin me numër Ref:095/14 i datës 19.02.2014; Vendimin me Nr.Ref:183/2016 i datës 06.05.2016; Vendimin me Nr.584/2018 i datës 13.07.2018; Vendimin me Nr.Ref:92/2020 i datës 27.03.2020; Vendimin me Nr.332/2020 i datës 10.07.2020; Vendimin me Nr.114/2020 i datës 01.09.2020; Akt Emërimit AE.Nr.29/2021 i datës 15.06.2021 në emër të ankueses; Vendimin me Nr.Ref:153/2022 i datës 15.03.2022; Njoftimin për intervistë i datës 02.06.2012 për ankuesen nga Zyra e Personelit MPJ; Ftesë për pjesëmarrje në testim datë 28.01.2012 për ankuesen nga Zyra e Personelit MPJ; Njoftimin për testim për gjuhë angleze i datës 06.02.2012; Emailin e datës 06.02.2012 nga ankuesja; Emailin e datës 09.02.2012 për ankuesen; Njoftimin për testim për gjuhë gjermane i datës 01.02.2012; Njoftim mbi fillimin e punës së ankueses i datës 18.03.2014; Njoftim lidhur me vendimin i datës 21.02.2014; Emailin e datës 20.02.2014 për ankuesen; Emailin e datës 21.02.2014 nga ankuesja; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 20.04.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 26.04.2022; Kërkesën për punësim të ankueses i datës 19.08.2011; Emailin e datës 26.03.2022 për ankuesen; Ankesën A.nr.370/2022 të datës 14.04.2022 me numër protokollin 2092/2022 e parashtruar nga ankuesi Adnan Dragaj në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura: Autorizimin e datës 17.03.2022; Vendimin me Nr.Ref:1064/12 të datës 13.11.2012; Vendimin me Nr.Ref:244/14 të datës 25.04.2014; Vendimin me Nr.561/2018 të datës 13.07.2018; Vendimin me Nr.345/2019 16.07.2019; Vendimin me Nr.431/2019 i datës 08.09.2019; Vendimin me Nr. Ref:102/2020 i datës 27.03.2020; Akt Emërimit AE.Nr.01/2021 i datës 19.02.2021; Vendimin me Nr. 111/2020 i datës 01.09.2020; Emailin e datës 31.05.2021; Emaili e datës 02.06.2012; Emailin e datës 06.02.2012; Vendimin me Nr.Ref:150/2022 i datës 15.03.2022; Kërkesën për Përgjigje në ankesë e datës 22.04.2022; Përgjigje në ankese e datës 29.04.2022; Kërkesën për punësim të ankuesit; Certifikatën e datës 22.08.2011 për ankuesin; CV-në e ankuesit; Dëshmi për dokumentet e dorëzuara datës 22.08.2011; Certifikatën shëndetësore e datës 20.08.2011; Provë shtesë nga MPJD e datës 11.05.2022; Dekretin me Nr.DMD-009-2009 i datës 20.10.2009; Ankesën A.nr.371/2022 të datës 14.04.2022 me numër protokollin 2093/2022 e parashtruar nga ankuesi Enver Buçaj në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura: Autorizimin e datës 17.03.2022; Vendimin me Nr.Ref:421/14 i datës 28.05.2014; Vendimin me Nr.346/2016 i datës 12.08.2016; Vendimin me Nr.583/2018 i datës 13.07.2018; Vendimin me Nr.Ref:103/2020 i datës 27.03.2020; Vendimin me Nr.Ref:333/2020 i datës 10.07.2020; Vendimin me Nr.Ref:996/2020 i datës 10.12.2020; Vendimin me Nr.Ref:19/2021 i datës 01.02.2021; Vendimin me Nr. Ref:146/2022 i datës 15.03.2022; Emailin e datës 02.06.2012 nga Zyra

e Personelit e MPJ për ankuesin; Njoftimin për testim për gjuhën kroate/serbe dhe boshnjake i datës 31.01.2012; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 15.04.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 29.04.2022; Provë shtesë nga MPJD e datës 11.05.2022; Dekretin me Nr.DMD-008-2009 i datës 10.02.2009; Ankesën A.nr.372/2022 të datës 14.04.2022 me numër protokollit 2094/2022 e parashtruar nga ankuesi Blerim Canaj në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura: Autorizimin e datës 17.03.2022; Vendimin me Nr.Ref:1059/12 i datës 13.11.2012; Vendimin me Nr.Ref: 042/2015 i datës 30.12.2015; Vendimin me Nr.Ref:894/2018 i datës 06.11.2018; Vendimin me Nr.321/2020 i datës 10.07.2020; Vendimin me Nr.116/2020 i datës 01.09.2020; Vendimin me Nr.Ref:145/2020 i datës 15.03.2022; Njoftimin e datës 19.12.2012 për fillimin e detyrës për ankuesin; Ftesë për pjesëmarrje në testim nga Zyra e Personelit MPJ e datës 28.01.2012; Njoftimin për testim për gjuhën kroate/serbe dhe boshnjake e datës 31.01.2012; Njoftimin për testim për gjuhë gjermane i datës 07.02.2012 për ankuesin; Njoftimin për testim për gjuhë angleze i datës 07.02.2012; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 21.04.2012; Përgjigjen në ankesë e datës 29.04.2022; Vendimin me Nr.Ref:295/2019 i datës 21.06.2019; Vendimin me Nr.45/2018 i datës 18.01.2018; Vendimin me Nr.Ref:112/2020 i datës 27.03.2020; Kërkesën për punësim të ankuesit e datës 19.08.2011; CV-në e ankuesit; Certifikatën e datës 16.08.2011; Certifikatën shëndetësore të datës 16.08.2011; Dëshmi për dokumentet e dorëzuara datë 22.08.2011; Provë shtesë e datës 11.05.2022 nga MPJD; Dekretin me Nr.DMD-007-2008 i datës 18.06.2008; Dekretin me Nr.DMD-006-2009 i datës 10.02.2009; Provë shtesë e datës 24.05.2022 nga MPJD; Parashtresë e datës 01.06.2022 nga MPJD; Ftesë për seancë publike të datës 29.04.2022, 11.05.2022 dhe 13.05.2022; Procesverbal i seancës i datës 18.05.2022 dhe 20.05.2022; Vendimin me Nr.21/2022 i datës 05.05.2022 për bashkimin e ankesave të ankuesve; Vendimin me numër VK.nr.47/2022 i datës 24.05.2022 për shtyrjen e afatit për vendosje të ankesës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas administrimit të shkresave të lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, dhe pas mbajtjes së seancës dëgjimore me datë 18 dhe 20 maj 2022, me shumicë votash konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.365/2022 të datës 14.04.2022 të parashtruar nga ankuesit, *sepse*:

Nga analizimi i provave materiale Kolegji ka konstatuar se Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme me Vendimin Nr.140/11 të datës 21.07.2011 ka miratuar shpalljen e Konkursit për përfaqësues diplomatik dhe konsullor në misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës. Bazuar në këtë vendim, Ministria e Punëve të Jashtme më datë 22.07.2011 shpall Konkursin për drejtues dhe nëpunës të tjerë të misionit konsullor dhe për anëtarë të misionit diplomatik, e në të cilin konkurs kishin aplikuar edhe ankuesit. Me tej, nga shkresat e lëndës rezultojnë së lidhur me këtë procedurë konkurrimi ishte organizuar vetëm testimi i gjuhëve të huaja dhe intervista me gojë, dhe nga kjo fazë nuk ka dëshmi për vazhdimin e mëtejshëm të procesit të rekrutimit në fjalë, gjegjësisht pranimit të ankuesve në pajtim me dispozitat e aplikueshme për shërbimin e jashtëm dhe shërbim civil.

Rrjedhimisht nga shqyrtimi i provave materiale Kolegji ka konstatuar se ankuesit janë emëruar në shërbim të jashtëm mbi bazën e vendimeve të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe po me të njëjtat vendime ishin caktuar që të shërbejnë në misione të caktuara diplomatike dhe konsullore respektivisht ankuesi Lulzim Rifaj me Vendimin Nr.Ref:1060/12 të datës 13.11.2012 emërohet anëtar i shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës duke ju caktuar grada konsullore-"Konsull", dhe njëkohësisht caktohet që të shërbejë në Ambasadën e Republikës së

Kosovës në Bullgari duke filluar nga data 01.12.2012, ankuesi Frymëzim Isufaj me Vendimin me Nr.Ref: 127/13 të datës 20.03.2013 emërohet anëtar i shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës duke ju caktuar grada diplomatike "Këshilltar", dhe njëkohësisht caktohet që të shërbej në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Federatën e Belgjikës-Bruksel, duke filluar nga data 01.11.2013, ankuesi Mitat Fejza me Vendimin Nr.Ref:242/13 të datës 10.05.2013 ishte emëruar anëtar i shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës duke ju dhënë grada konsullore-"Konsull", e po me vendim të njëjtë caktohet të shërbejë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Paris-Francë, ankuesja Bahrije Hoti sipas Vendimit më Nr.Ref:193/14 të datës 08.04.2014 ishte emëruar anëtare e shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës duke ju caktuar grada konsullore "Konsull", dhe njëkohësisht e njëjta është caktuar që të shërbej në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Bern/ Zvicër, duke filluar nga data 01.05.2014, ankuesi Rrahim Morina sipas Vendimit Nr.Ref:725/2012 të datës 26.07.2012 emërohet anëtar i Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës duke ju caktuar grada diplomatike *Ministër-Këshilltar*. I njëjti, me Dekretin DED-016-2012 të datës 31.07.2012 të Presidentes së Republikës së Kosovës është emëruar Konsull i Përgjithshëm në Ambasadën e Kosovës në Stamboll/Turqi, ankuesi Binak Berisha me Vendimin Nr.Ref:1061/12 të datës 13.11.2012 ishte emëruar anëtar i shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht emërohet të shërbej në gradën diplomatike "Këshilltar", në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Republikën Federale të Gjermanisë duke filluar nga data 01.12.2012, ankuesi Adnan Dragaj me Vendimin Nr.Ref:1064/12 të datës 13.11.2012 emërohet anëtar i shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës duke ju caktuar grada diplomatike "Ministër Këshilltar" dhe po me vendim të njëjtë është caktuar që të shërbejë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Republikën e Maqedonisë, Ankuesja Shota Bukoshi me Vendimin Nr.Ref:095/14 të datës 19.02.2014 ishte emëruar anëtare e shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës duke ju caktuar grada diplomatike "Sekretare e Parë" dhe njëkohësisht është caktuar që të shërbej në Republikën Federale të Gjermanisë, ankuesi Enver Buçaj me Vendimin Nr.Ref:421/14 të datës 28.05.2014 të Ministrisë të MPJ-së emërohet anëtar i shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës duke ju caktuar grada diplomatike Këshilltar dhe njëkohësisht caktohet që të shërbej në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Suedisë, duke filluar nga data 01.08.2014, Ankuesi Blerim Canaj sipas Vendimit Nr.Ref:1059/12 të datës 13.11.2012 të Ministrisë të MPJ-së është emëruar anëtar i shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës duke ju dhënë grada diplomatike "Këshilltar" dhe njëkohësisht po me këtë vendim emërohet të shërbej në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Republikën e Austrisë, duke filluar nga data 13.11.2012.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton së Ministria e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me vendimet e kundërshtuara me ankesë ka shfuqizuar vendimet për emërimin e ankuesve në shërbime të jashtëm si dhe çdo vendim tjetër të pasuar nga këto vendime, mbi bazën ligjore se emërimi i ankuesve në shërbime të jashtëm është bërë në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit Nr.03/L-022 për Shërbimin e Jashtëm.

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendojnë që vendimet e kundërshtuara me ankesë janë rezultat i shkeljeve të dispozitave ligjore procedurale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljeve të ligjit material, konkretisht Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.03/L-022 për Shërbimin e Jashtëm dhe Ligjit Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në përgjigjen në ankesë, parashtrësën e datës 24.05.2022 si dhe në seancë dëgjimore kanë pohuar së Konkursi i vitit 2011 e në të cilin kishin aplikuar ankuesit, nuk kishte përfunduar si proces, pasi që nuk ka pas listë finale të kandidatëve të përzgjedhur dhe së të njëjtit janë emëruar sipas vendimeve të ministrit duke u graduar dhe dërguar në misione të jashtë pa respektim të procedurave të gradimit sipas nenit 8 paragrafi 1.3 dhe nenin 9 të paragrafi 2 të Rregullores 02/2009 për Shërbimin e Jashtëm, rrjedhimisht procedura e emërimit të ankuesve është bërë në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm.

Në kuptim të pranueshmërisë së ankesës, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës i aplikueshëm në kohën e emërimit të ankuesve në shërbim të jashtëm, përkatësisht nenit 3 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *4. Personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi, si dhe nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik me të cilin parashihet: Anëtarët e Shërbimit Diplomatik të Kosovës, përveç të emëruarve politik, janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe personeli i tij i nënshtrohet të njëjtave paga, kërkesa dhe kushte të punës, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose me ligje tjera ose akte nënligjor, dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji me shumicë votash konstaton se përveç të emëruarve politikë, nëpunësit e shërbimit të jashtëm përfshirë personelin diplomatik, konsullor dhe personelin administrativ të punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme apo të angazhuar në shërbim të jashtëm, kanë statusin e nëpunësit civil dhe së pranimit i tyre në shërbim të jashtëm duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e legjislacionit për shërbim të jashtëm dhe legjislacionit të aplikueshëm për shërbim civil, andaj mbi këtë bazë ligjore, si dhe duke marrë parasysh faktin se ankuesit ishin emëruar në shërbim të jashtëm mbi bazën e vendimeve të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, e meqenëse me asnjë provë nuk vërtetohet së të njëjtit kanë themeluar marrëdhënie të punës në shërbim civil përmes nënshkrimit të Aktit të emërimit ashtu siç përcaktohej me nenin 19 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me të cilin përcaktohet se: *Nëpunësit civilë themelojnë marrëdhënien e punës pas përfundimit me sukses të procedurave të pranimit të përcaktuara me këtë ligj dhe me aktet përkatëse nënligjore dhe pas pranimit të një shkrese të emërimit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të procedurës nga institucioni kompetent në të cilën do të gjejë punë nëpunësi i ri civil....*, Kolegji duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, me shumicë votash konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesve si në dispozitiv të këtij vendimi.*

Bazuar në rrethanat si me lartë, Kolegji për shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit të provave të lëndës, e duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me shumicë votash vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.



**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.365/2022

**AvdyL BEKTESHI**

*Bektashi*  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

*Ardita*  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesve Avokat Faton Fetahu dhe Avokat Hajzer Salihu;
- Zëvendëskryeminstres dhe Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ;
- Arkivit të KPMSHCK-së





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.365/2022**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Jeton Koca, anëtar i Kolegjit për shqyrtimin e ankesës A.nr.365/2022 të datës 14.04.2022 të parashtruar nga ankuesi Lulzim Rifaj, e bashkuar sipas Vendimit me Nr.21/2022 të datës 05.05.2022, dhe të përfaqësuar nga avokati Hajzer Salihu dhe avokati Faton Fetahu, nga Prishtina, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 17 të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën e datës 10.06.2022, paraqet këtë:

**MENDIM**  
**MOSP AJTUES**

*me*

Vendimin e Kolegjit për Shqyrtimin e Ankesave në rastin e vendosjes së ankesës A.nr.365/2022 të datës 14.04.2022 të parashtruar nga ankuesi Lulzim Rifaj, e bashkuar sipas Vendimit me Nr.21/2022 të datës 05.05.2022

**Arsyetim**

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, ka shqyrtuar ankesën A.nr.365/2022 të datës 14.04.2022 të parashtruar nga ankuesi Lulzim Rifaj, e cila ankesë sipas Vendimit me Nr.21/2022 të datës 05.05.2022, është bashkuar me ankesën A.nr.214/2022 të datës 09.03.2022 të parashtruar nga ankuesi Frymëzim Isufaj, ankesën A.nr.372/2022 të datës 14.04.2022 të parashtruar nga ankuesi Blerim Canaj, ankesën A.nr.371/2022 të datës 14.04.2022 të parashtruar nga ankuesi Enver Buçaj, ankesën A.nr.370/2022 të datës 14.04.2022 të parashtruar nga ankuesi Adnan Dragaj, ankesën A.nr.369/2022 të datës 14.04.2022 të parashtruar nga ankuesja Shota Bukoshi, ankesën A.nr.368/2022 të datës 14.04.2022 të parashtruar nga ankuesi Binak Berisha, ankesën

A.nr.367/2022 të datës 14.04.2022 të parashtruar nga ankuesi Rrahim Morina, ankesën A.nr.366/2022 të datës 14.04.2022 të parashtruar nga ankuesja Bahrije Hoti, dhe ankesën A.nr.364/2022 të datës 14.04.2022 të parashtruar nga ankuesi Mitat Fejza, kundër vendimeve të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, dhe atë Vendimit Nr.ref: 152/2022 të datës 15.03.2022, Vendimit Nr.68/2022 të datës 07.02.2022, Vendimit Nr.Ref:145/2022 të datës 15.03.2022, Vendimit Nr.Ref:146/2022 të datës 15.03.2022, Vendimit Nr.ref:150/2022 të datës 15.03.2022, Vendimit Nr.ref:153/2022 të datës 15.03.2022, Vendimit Nr.ref:148 të datës 15.03.2022, Vendimit Nr.144/2022 të datës 15.03.2022, Vendimit Nr.ref:147/2022 të datës 15.03.2022, dhe Vendimin Nr.ref:149/2022 të datës 15.03.2022, me të cilat vendime ankuesit janë larguar nga shërbimi i jashtëm diplomatik dhe konsullor i Republikës së Kosovës dhe rrjedhimisht ju është ndërpre marrëdhënia e punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës dhe pas diskutimeve të mbajtura, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me shumicë të votave ka marr vendim me të cilin ka vendosur që:

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës të **shpallet jo kompetent** për të vendosur për ankesën A.nr.365/2022 të datës 14.04.2022 të parashtruar nga ankuesi Lulzim Rifaj, e bashkuar sipas Vendimit me Nr.21/2022 të datës 05.05.2022.

Bazuar në dispozitat e nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe dispozitat e nenit 17 të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në cilësinë e anëtarit të Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në seancën e datës 10.06.2022, me respekt ndaj dy anëtarëve që kanë përbër shumicën në Kolegj, paraqes **mendim mospajtues** lidhur me vendimin A.nr.365/2022 të datës 10.06.2022, për arsyet e ofruara si në vijim:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, **me shumicë të votave** ka konstatuar së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën A.nr.365/2022 të datës 14.04.2022 me arsyetimin se ankuesit ashtu sikurse edhe organi i punësimit nuk kanë mundur të sjellin dëshmi lidhur me faktin se ankuesit në kohën e emërimit në shërbimin e jashtëm - diplomatik dhe konsullor të Republikës së Kosovës, sipas konkursit të datës 22.07.2011 të kenë nënshkruar akt emërimi, siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 19 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *1. Nëpunësit civilë themelojnë marrëdhënien e punës pas përfundimit me sukses të procedurave të pranimit të përcaktuara me këtë ligj dhe me aktet përkatëse nënligjore dhe pas pranimit të një shkrese të emërimit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të procedurës nga institucioni kompetent i administratës publike, në të cilën do të gjejë punë nëpunësi i ri civil.* Ky konstatim është nxjerr nga Kolegji, duke u koncentruar vetëm në aktin e emërimit, gjegjësisht mungesën e nënshkrimit të aktit të emërimit me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës të ankuesve.

Në cilësinë e anëtarit të Kolegjit, vlerësoj se shpallja jo kompetent e Këshillit për vendosjen e ankesës A.nr.365/2022 të datës 14.04.2022, duke u referuar vetëm në çështjen e mungesës së aktit

të emërimit të ankuesve, nuk është vlerësim i drejtë dhe i bazuar, sepse me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Kosovës, i zbatueshëm në kohën e emërimit të ankuesve në shërbim të jashtëm të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 3 paragrafi 4 është përcaktuar se: *4. Personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi.* Pra, në parim është e pa kontestueshme se personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës, ashtu siç është e pakontestueshme se të punësuarit në shërbimin e jashtëm i nënshtrohen legjislacionit të aplikueshëm për shërbimin civil dhe legjislacionit të veçantë që rregullon shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës.

Andaj, në këtë kuptim, vlerësoj se çështja e statusit të të punësuarve në shërbimin e jashtëm ka qenë e përcaktuar me nenin 3 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Kosovës, dhe pothuajse në mënyrë të njëjtë është e përcaktuar edhe me ligjin aktual, gjegjësisht me nenin 4 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, dhe rrjedhimisht ashtu sikurse me ligjin e aplikueshëm në kohën e themelimit të marrëdhënies së punës të ankuesve, edhe me ligjin aktual, përcaktohet se nëpunësit e shërbimit të jashtëm - diplomatik dhe konsullor, përjashtimisht të emëruarve politik, **kanë statusin e nëpunësit civil** dhe të njëjtit i nënshtrohen përveç këtij ligji edhe legjislacionit të veçantë.

Duke ju referuar këtyre dispozitave ligjore, si dhe nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik, ku përcaktohet se: *Anëtarët e Shërbimit Diplomatik të Kosovës, përveç të emëruarve politik, janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe personeli i tij i nënshtrohet të njëjtave paga, kërkesa dhe kushte të punës, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose me ligje tjera ose akte nënligjor, dhe pas konstatimit se ankuesit janë të emëruar në pozita të cilat hynë në kuadër të fushëveprimit të shërbimit civil, vlerësoj se çështja e kompetencës në rrethanat e rastit konkret nuk duhet të lidhet vetëm me aktin formal të themelimit të marrëdhënies së punës, por me pozitën në të cilën ankuesit janë emëruar dhe kanë ushtruar detyrën, dhe në këtë kuptim, në cilësinë e anëtarit të Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për dallim nga dy anëtarët e Kolegjit, vlerësoj se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është kompetent për vendosjen e ankesës A.nr.365/2022 të datës 14.04.2022, ndërsa lidhur me mënyrën e vendosjes meritore, duke ju referuar shkresave të lëndës, vlerësoj se ka bazë për aprovim të ankesës, **sepse:***

Bazuar në provat e lëndës, rezulton se Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme, më datë 21.07.2011 kishte nxjerrë Vendimin Nr.140/11 për miratimin e shpalljes së konkursit për përfaqësues diplomatik dhe konsullor në misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës. Bazuar në këtë vendim, Ministria e Punëve të Jashtme më datë 22.07.2011 ka shpallur konkurs publikë për drejtues dhe nëpunës të tjerë të misionit konsullor dhe për anëtarë të misionit diplomatik, e në të cilin konkurs kishin aplikuar edhe ankuesit. Me tej nga shkresat e lëndës rrjedh se ankuesit si rezultat i këtij konkursi janë emëruar anëtar të shërbimit të jashtëm - diplomatik dhe konsullor, dhe atë: Ankuesi Lulzim Rifaj me Vendimin Nr.Ref:1060/12 të datës 13.11.2012 emërohet anëtar i shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës, në gradën "Konsull", dhe caktohet të shërbejë në Ambasadën e Kosovës në Bullgari, Ankuesi Frymëzim Isufaj me

Vendimin me Nr.Ref: 127/13 të datës 20.03.2013 emërohet anëtar i shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës në gradën diplomatike "Këshilltar", dhe caktohet të shërbejë në Ambasadën e Kosovës në Belgjikë, Ankuesi Mitat Fejza me Vendimin Nr.Ref:242/13 të datës 10.05.2013 emërohet anëtar i shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës, në gradën konsullore "Konsull", dhe caktohet të shërbejë në Ambasadën e Kosovës në Francë, Ankuesja Bahrije Hoti sipas Vendimit më Nr.Ref:193/14 të datës 08.04.2014 emërohet anëtare e shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës, në gradën konsullore "Konsull", dhe caktohet të shërbejë në Zvicër, Ankuesi Rrahim Morina sipas Vendimit Nr.Ref:725/2012 të datës 26.07.2012 emërohet anëtar i shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës, në gradën diplomatike *Ministër-Këshilltar* dhe caktohet të shërbejë në Turqi, Ankuesi Binak Berisha me Vendimin Nr.Ref:1061/12 të datës 13.11.2012 emërohet anëtar i shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës në gradën diplomatike "Këshilltar" dhe caktohet të shërbejë në Ambasadën e Kosovës në Gjermani, Ankuesi Adnan Dragaj me Vendimin Nr.Ref:1064/12 të datës 13.11.2012 emërohet anëtar i shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës në gradën diplomatike "Ministër-Këshilltar" dhe caktohet të shërbejë në Ambasadën e Kosovës në Maqedoni, Ankuesja Shota Bukoshi me Vendimin Nr.Ref:095/14 të datës 19.02.2014 emërohet anëtare e shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës në gradën diplomatike "Sekretar i Parë" dhe caktohet të shërbejë në Ambasadën e Kosovës në Gjermani, Ankuesi Enver Buçaj me Vendimin Nr.Ref:421/14 të datës 28.05.2014 emërohet anëtar i shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës në gradën diplomatike "Këshilltar" dhe caktohet të shërbejë në Ambasadën e Kosovës në Suedi, Ankuesi Blerim Canaj sipas Vendimit Nr.Ref:1059/12 të datës 13.11.2012 emërohet anëtar i shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës në gradën diplomatike "Këshilltar" dhe caktohet të shërbejë në Ambasadën e Kosovës në Austri.

Organi i punësimit pretendon se vendimet mbi emërimin e ankuesve në shërbimin e jashtëm diplomatik dhe konsullor janë të paligjshme për shkak se i njëjti nuk posedon dëshmi se procedura e filluar sipas konkursit të datës 22.07.2011 të ketë përfunduar, gjegjësisht nuk ka dëshmi se procedura e filluar ka përfunduar me një listë përfundimtare të kandidateve të suksesshëm. Respektivisht organi i punësimit pretendon se ankuesit janë emëruar sipas vendimeve të ministrit duke u graduar dhe dërguar në misione të jashtë pa respektim të procedurave të gradimit sipas dispozitave të Rregullores 02/2009 për Shërbimin e Jashtëm, rrjedhimisht procedura e emërimit të ankuesve është bërë në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm. Ndërsa, ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendojnë se i janë nënshtruar të gjitha procedurave të konkursit dhe vlerësojnë se vendimet e kundërshtuara me ankesë, gjegjësisht vendimet e Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me të cilat vendime janë shfuqizuar vendimet mbi emërimin e ankuesve në shërbimin e jashtëm diplomatik dhe konsullor të Republikës së Kosovës, janë nxjerr përmes shkeljeve të dispozitave ligjore procedurale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljeve të ligjit material, duke ju referuar kështu Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.03/L-022 për Shërbimin e Jashtëm dhe Ligjit Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Sipas shkresave të lëndës rezulton se të gjithë ankuesit në shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës, janë pranuar duke ju nënshtruar konkursit publik të shpallur nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës, dhe pas emërimit nga Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme, si autoritet përgjegjës sipas nenit 9 të Udhëzimit Administrativ Nr.03/2009 për Procedurat e Emërimit të Kandidateve për Nëpunës të Misionit Diplomatik. Po ashtu, nga shkresat e lëndës del se çështja e aplikimit të ankuesve në konkursin e datës 22.07.2011 të shpallur nga Ministria e Punëve të Jashtme, nuk është kontestuese as nga vet organi i punësimit.

Andaj, meqenëse me prova të lëndës vërtetohet mjaftueshëm se të gjithë ankuesit ju kanë nënshtruar konkursit publikë, gjegjësisht kanë aplikuar në konkursin publikë të datës 22.07.2011 për pranim në shërbimin e jashtëm diplomatik dhe konsullor të Republikës së Kosovës, dhe të njëjtit janë emëruar nga autoriteti përgjegjës, në këtë rast Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme, vlerësoj se çështja e mirëmbajtjes së procedurës gjegjësisht ruajtjes së dokumenteve mbi zhvillimin e një procedure të rekrutimit është përgjegjësi e organit të punësimit, dhe se palët nuk mund të pësojnë nga mungesa e eventuale e dokumentacionit përkatës.

Po ashtu, vlerësojë se vendimet e kontestuara nga ankuesit janë në kundërshtim edhe me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse sipas nenit 54 të këtij ligji janë përcaktuar rastet e anulimit të detyrueshëm të një akti administrativ të paligjshëm, ku me paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se: *1. Një akt administrativ i paligjshëm duhet të anulohet, nëse. 1.1. është nxjerrë nën shtrëngim, zhvatje, shantazh, mashtrim, kanosje, ryshfet apo nën ndikimin e një veprë tjetër penale; 1.2. objekti i tij është ligjërishit apo materialisht i pamundur, apo 1.3. zbatimi i aktit do të përbënte veprë penale.* Pra me këtë dispozite ligjore është përcaktuar në mënyrë shprehimore se në cilat raste akti administrativ detyrimisht duhet të anulohet, qoftë sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj. Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës të asnjëri nga ankuesit nuk janë plotësuar kushtet për anulimin e detyrueshëm të aktit administrativ, siç përcaktohet me nenin 54 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe kjo vërtetohet nga fakti se organi i punësimit nuk është referuar në këtë dispozite ligjore me rastin e nxjerrjes së akteve të kontestuara.

Ndërsa, për dallim nga neni 54, me nenin 55 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative është përcaktuar se: *1. Një akt administrativ i paligjshëm për arsye të tjera nga ato të parapara nga neni 54 i këtij Ligji, mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllimin për të vendosur ligjshmërinë,* ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni është përcaktuar se: *2. Një akt administrativ dobiprurës i paligjshëm, nëse pala përfituese është në mirëbesim, nuk mund të anulohet, por vetëm mund të shfuqizohet.*

Organi i punësimit, me rastin e nxjerrjes së akteve të kontestuara, me të cilat ka shfuqizuar vendimet mbi emërimin e ankuesve, në preambulë i është referuar kësaj dispozite ligjore (nenit 55 paragrafi 2) me çka mund të konstatohet se edhe vet organi i punësimit, ankuesit si palë në këtë procedure i konsideron me mirëbesim.

Afati kohor për anulimin dhe shfuqizimin e aktit administrativ është rregulluar me dispozitat e nenit 58 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku me paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se: *1. Anulimi në rastin e paraparë nga neni 55 i këtij Ligji si dhe*

*shfuqizimi në rastin e paraparë nga paragrafi 1 i nenit 57 të këtij Ligji, mund të bëhet në çdo kohë, ndërsa me paragrafin 2 të po këtij neni përcaktohet se: 2. Anulimi apo shfuqizimi, në çdo rast tjetër mund të bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur organi publik i përcaktuar sipas paragrafit 1 të nenit 53 të këtij Ligji, njihet me faktet që justifikojnë anulimin apo shfuqizimin, por jo me vonë se pesë (5) vjet nga njoftimi i aktit administrativ.*

Paragrafi 1 i nenit 58, si i tillë i referohet dy çështje të ndryshme: a) anulimit të aktit administrativ të paligjshëm, në rastin kur plotësohen kushtet e anulimit, dhe që ka të bëjë me rastet kur pala konsiderohet me keqbesim, dhe b) shfuqizimit të aktit administrativ të ligjshëm për shkak të ndryshimit të situatës apo rrethanave faktike ose ligjore apo për shkak të arsyeve tjera të parapara me ligj.

Organi i punësimit, me rastin e shfuqizimit të vendimeve mbi emërimin e ankuesve në shërbimin e jashtëm diplomatik dhe konsullor, në preambulë të vendime i është referuar nenit 55 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozite kjo që flet për shfuqizimin e aktit administrativ kur palët janë me mirëbesim, ndërsa në aspektin e vlerësimit kohor të paligjshmërisë së aktit administrativ ka aplikuar nenin 58 paragrafi 1, për çka vlerësoj se në rrethanat e rastit konkret është vepruar në kundërshtim me dispozitat procedurale, për shkak se neni 58 paragrafi 1 i referohet vetëm anulimit të aktit administrativ të paligjshëm, ndërsa shfuqizimit i referohet vetëm për rastin e paraparë nga paragrafi 1 i nenit 57 të këtij Ligji, të cilat raste lidhen me ndryshimin e situatës apo rrethanave faktike ose ligjore. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, në cilësinë e anëtarit të Kolegjit konstatoi se vendimet e Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, të kontestuar nga ankuesit, janë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 58 paragrafi 2 ku përcaktohet se: 2. *Anulimi apo shfuqizimi, në çdo rast tjetër mund të bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur organi publik i përcaktuar sipas paragrafit 1 të nenit 53 të këtij Ligji, njihet me faktet që justifikojnë anulimin apo shfuqizimin, por jo me vonë se pesë (5) vjet nga njoftimi i aktit administrativ*, sepse sipas shkresave të lëndës ankuesit janë pranuar në shërbimin e jashtëm diplomatik dhe konsullor në vitin 2012-2014, ndërsa vendimet e kontestuara nga ankuesit janë nxjerr nga organi i punësimit në vitin 2022.

Andaj, vlerësoj se vendimet e kontestuara nga ankuesit, si të tilla janë të paligjshme në kuptim të dispozitave të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe konsideroj se kjo paligjshmëri cenon rendë parimin e sigurisë juridike.

Kështu që duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 17 të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mendimi im është që Kolegji të nxjerrë këtë:

## V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa A.nr.365/2022 e datës 14.04.2022 e parashtruar nga ankuesi Lulzim Rifaj, e bashkuar sipas Vendimit me Nr.21/2022 të datës 05.05.2022.

- II. **Shfuqizohet** Vendimi Nr.ref: 152/2022 i datës 15.03.2022, Vendimi Nr.68/2022 i datës 07.02.2022, Vendimi Nr.Ref:145/2022 i datës 15.03.2022, Vendimi Nr.Ref:146/2022 i datës 15.03.2022, Vendimi Nr.ref:150/2022 i datës 15.03.2022, Vendimi Nr.ref:153/2022 i datës 15.03.2022, Vendimi Nr.ref:148 i datës 15.03.2022, Vendimi Nr.144/2022 i datës 15.03.2022, Vendimi Nr.ref:147/2022 i datës 15.03.2022, dhe Vendimi Nr.ref:149/2022 i datës 15.03.2022, të Ministres se Ministrisë se Punëve të Jashtme dhe Diasporës.
- III. **Obligohet** Ministrja e Ministrisë se Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të zbatoj këtë vendim brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, duke kthyer ankuesit në vendin e punës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.365/2022**

  
Jeton KOCA  
Anëtar i Kolegjit

**Mendimi Mospajtues i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve, Av.Hajzer Salihu, dhe Av.Faton Fetahu;
- Ministres se Ministrisë se Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

